



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE  
REKTORATI

Nr. 1930/3 Prot.

Vlorë, më. 13.12.2021

VENDIM

NR. 36, datë 13. 12. 2021

PËR

MIRATIMI I PROPOZIMEVE TË EKSPERTËVE TË JASHTËM NË KUADËR TË  
PROJEKTIT "BOLOGNA HUB PEER SUPPORT"

Bazuar në Nenin 40 të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Nenit 26 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, referuar shkresës Nr.1783 Prot, datë 22. 11. 2021, të Zv. Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillim Institucional, Rektorati, në mbledhjen e zhvilluar në datën 13. 12. 2021,


VENDOSI

1. Përgatitjen e draft-dokumentit të brendshëm mbi zhvillimin dhe zbatimin e qasjes mësimdhënëse mbështetur në rezultatet e të nxëniet në syllabuset dhe programet e studimit.
2. Përditësimin e faqes së Webit të UV-së me qëllim lehtësimin e përdorimit (user-friendly) nga studentët që realizojnë mobilitete.
3. Pasqyrimi në faqen e Webit të UV-së i katalogut të kurseve në gjuhën angleze.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: njësitë kryesore, njësitë bazë, Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore si edhe Zv. Rektori për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillim Institucional.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe arkivohet

REKTORI

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
Zv. REKTOR PËR KËRKIM SHKENCOR DHE ZHVILLIM INSTITUCIONAL


Nr. 1783 Prot

Vlorë, më 22 / 11 / 2021

**Lënda:** Përcjellja Raportit të Vizitës Këshillues prej Ekspertëve të jashtëm në kuadër të projektit "Bologna Hub Peer Support".

**PROF. DR. ROLAND ZISI**  
REKTOR


*Pei mbledhje Rektorati!  
informim, distruktu dhe  
motive: propozit të  
punë!*



Në përfundim të takimit të parë këshillues, organizuar online më datë 02 nëntor 2021 në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, me ekspertët e jashtëm Dr. Ilir Alfuna dhe Mirë Raimonda Markeviciene në kuadër të projektit "Bologna Hub Peer Support", financuar prej Komisionit Europian dhe Ministrisë Federale të Edukimit dhe Kërkimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në Shqipëri; Ministrinë e Edukimit dhe Shkencës në Ukrainë; Ministrinë e Edukimit, Shkencës, Kulturës dhe Sportit në Gjeorgji; Universitetin Espanolas; Unionin Europian të Studentëve si dhe Akademinë Gjermane të Shkëmbimit të Shërbimeve, përcillet bashkëlidhur Raporti Vlerësues. Prej komponentëve kyç të Kartës së Bolonjës objekt i vlerësimit ishte struktura dhe implementimi i tre cikleve të studimit Bachelor-Master-Doktoraturë në Institucionet e Arsimit të Lartë, duke u fokusuar specifikisht në çështjet që vijojnë: Formulimi i Rezultateve të të Nxënës; Zhvillimi i Kurrikulave; Qasjet Inovative në Mësimdhënie e Mësimnxënie (si psh. Dixhitalizmi); Mobilitetet dhe Ndërkombëtarizimi. Gjatë takimit u prekën edhe çështje të tjera si sigurimi i cilësisë, struktura dhe zhvillimi i programeve të të tre cikleve të studimit.

Ekspertët e jashtëm kanë vlerësuar një sërë aspektesh në UV si masat e ndërmarra për të stimuluar përfshirjen e stafit në aktivitete ndërkombëtare, numrin e lartë të marrëveshjeve të partneritetit në kuadër të Erasmus+, bashkëpunimet dypalëshe, strategjinë aktive në kuadër të mobiliteteve, përpjekjet për të luajtur një rol kyç në zhvillimin e rajonit. Megjithatë në raport ata shprehën se institucioni përballet ende me një sërë sfidash si :

- Bashkëpunimi midis industrisë dhe universitetit;
- Ngritja e kulturës së Cilësisë në Universitet;
- Marrëdhëniet me Alumni.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Zv. REKTOR PËR KËRKIM SHKENCOR DHE ZHVILLIM INSTITUCIONAL


Vlen të theksohet se ekspertët vlerësojnë faktin se në institucion nuk mungojnë njohuritë mbi çështjet e trajtuara në takim megjithatë ka ende vështirësi në shfrytëzimin potencial të këtyre njohurive. Ashtu sikurse u dakortësua gjatë takimit online me strukturat e përfshira, deri në vizitën këshilluese e cila parashikohet të mbahet në fund Prill/ fillim Maj 2022, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë duhet të ndër marrë aktivitet që vijojnë:

1. Përgatitja e një draft-dokumenti të brendshëm mbi zhvillimin dhe përdorimin e qasjes mësimdhënëse mbështetur në rezultateve e të nxënësve në syllabuset dhe programet e studimit;
2. Përditësimi i faqes së Web-it të UV-së për të qenë më të lehta në përdorim (user-friendly) për studentët që realizojnë mobilitete.
3. Përditësimi në faqen e Web-it të UV-së i kurseve të lëndëve të ofruara në gjuhën angleze.

Mbështetur njëkohësisht në rekomandimet e mësipërme, në përfundim të raportit janë përcaktuar aktivitetet të cilat parashikohet të trajtohen në takimin e ardhshëm konsultues:

- Diskutimi i draft dokumentave të brendshëm/ strategjive të hartuara prej UV-së mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodologjive mwsimdhwnwse mwbshtetur nw rezultatet e të nxënësve si në nivelin e kurrikulave edhe të syllabuseve.
- Organizmi i Workshopit me stafin e institucionit mbi zhvillimin dhe përdorimin e rezultateteve të të nxënësve.
- Vlerësimi mbi mirë konceptimin dhe aplikueshmërinë e draft/dokumentave të përpiluar në universitet.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.



Zv. Rektor

Kërkim Shkencor dhe Zhvillim Institucional

Phd. Enkelejd Mëhilli